



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1495/8 Prot

Tiranë, më 10/12/2019

VENDIM

Nr. 34, datë 10.12.2019

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Instituti i Studimeve Politike, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1495/5 prot., datë 19.11.2019, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik “Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”).

Nëpërmjet kërkesës së datës 10.09.2019, depozituar në regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve pranë portalit “*PyetShtetin.al*”, ankuesi ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni dhe dokumentacioni, në lidhje me:

- *Listën emërore të deputetëve dhe ish deputetëve si dhe familjarëve të tyre që aktualisht zotërojnë pasaportë diplomatike nga MEPJ për shkak të funksionit parlamentar dhe ligjit mbi statusin e deputetit.*

Në mungesë të një përgjigje nga Autoriteti Publik/Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, ankuesi ka depozituar fillimisht ankesën nr. 1495 Prot., datë 27.09.2019, pranë Zyrës së Komisionerit.

Komisioneri, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me shkresën nr. 1495/1 Prot., datë 30.09.2019, i ka kërkuar Autoritetit Publik, përmbushjen e detyrimit për dhënie informacioni brenda datës 07.10.2019.

Në tejkalim të afatit të përcaktuar nga Komisioneri, me *e-mail-in* e datës 28.10.2019, Koordinatorin për të Drejtën e Informimit pranë Autoritetit Publik, ka kthyer përgjigje duke refuzuar vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar me argumentin se:



*"...Pasaporta e çdo lloji, është një dokument i lidhur me të dhënat personale të subjektivit mbajtes të saj, në këto kushte ky informacion kufizohet në përputhje me nenin 17 të ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" dhe ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar".*

Me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" në të cilin citohet se: *"Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve"* Komisioneri ftoi palët në seancë dëgjimore, e cila u zhvillua me praninë e ankuesit, Institutit të Studimeve Politike dhe përfaqësuesëve të Autoritetit Publik.

Gjatë seancës, përfaqësuesit e Autoritetit Publik, rikonfirmuan qëndrimin e reflektuar në e-mail-in e datës 28.10.2019 me argumentin se kemi të bëjme me një nga rastet e kufizimit të informacionit. Në përfundim të seancës, Komisioneri ftoi përfaqësuesit e Autoritetit Publik të rivlerësonin edhe një herë qëndrimin e tyre për dhënien e informacionit, duke dhënë afat deri me datë 06.11.2019.

Në tejkalim të afatit të sipërcituar, Koordinatori për të Drejtën e Informimit, me anë të e-mail-it të datës 13.11.2019, dërguar ankuesit si dhe për dijeni Zyrës së Komisionerit, ka rikonfirmuar qëndrimin e mbajtur më parë, duke refuzuar përsëri vënien në dispozicion të informacionit.

Në këto kushte ankuesi ka vijuar ankimin me nr. 1495/5 Prot., datë 19.11.2019. Zyra e Komisionerit i është drejtuar me një tjetër e-mail Autoritetit Publik, duke i kërkuar vënien në dispozicion të një kopje të plotë të praktikës objekt shqyrtimi, me qëllim evidentimin e personave që mund të ishin bërë pengesë për dhënien e informacionit.

Në mungesë të një reagimi nga ana e Autoritetit Publik, Komisioneri me Urdhrin nr.324, datë 20.11.2019, vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë tij, me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave, si dhe evidentimin e personave përgjegjës që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Në datën 21.11.2019 grupi i inspektimit i Zyrës së Komisionerit kontaktoi me Koordinatorin për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik, të cilit i kërkoi të mundësonte një takim me Sekretarin e Përgjithshëm (në cilësinë e titullarit administrativ të Autoritetit Publik) për arsye se Koordinatori iu referua miratimit nga ana e tij. Gjithashtu grupi i inspektimit kërkoi vënien në dispozicion të praktikës së plotë (kërkesën për informim së bashku me kartelën shoqëruese ku evidentohen personat e caktuar për trajtimin e kërkesës). Kërkesa e grupit të inspektimit u refuzua.

Pas parashtrimit të fakteve u hartua procesverbali të cilin Koordinatori për të Drejtën e Informimit refuzoi ta firmosë, me shënimin se në vlerësimin e autoritetit, kërkuesit i është kthyer përgjigje në përputhje me parashikimet ligjore përkatëse.



Pas konsultimit të dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se argumentet e parashtruara nga Autoriteti Publik për mos vënien në dispozicion të dokumentacionit nuk qëndrojnë.

Informacioni/dokumentacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*. Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit*”. Për rrjedhojë, në kushtet kur Autoriteti Publik, disponon informacionin, është përgjegjës për dhënien dhe vënien e tij në dispozicion të kërkuarit.

Për sa i përket pretendimit të Autoritetit Publik se informacioni i kërkuar (lista e deputetëve) përmban të dhëna personale dhe për këtë arsye i nënshtrohet kufizimeve të gjermës a, pika 1 e nenit 17 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, ky argument nuk qëndron. Bazuar në gjermën b të pikës 4 të nenit 4 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, *dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për përpunimin e të dhënave në ato raste kur jepet informacion për persona publikë zyrtarë..., nëpërmjet të cilit pasqyrohet aktiviteti publik, administrativ ose çështje lidhur me detyrën e tyre*.

Nga ana tjetër, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 389 datë 12.06.2019, “Për Kriteret për Lëshimin e Pasaportës Diplommatike dhe asaj të Shërbimit”, përcakton qartë rrethin e personave të cilët pajisen me të tilla pasaporta në lidhjen nr. 1 të tij.

Sa më sipër, informacioni lidhur me listën e deputetëve që janë pajisur me pasaporta diplomatike nuk i nënshtrohet kufizimeve të pikës 1 të gjermës a, pika 1 e nenit 17 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Përsa i përket informacionit lidhur me emrat e bashkëshortëve të deputetëve, ato mund të anonimizohen në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i cili përcakton se: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*.

Në lidhje me përgjegjësinë për refuzimin e dhënies së informacionit, për shkak të mungesës së bashkëpunimit nga ana e Autoritetit Publik, nuk u bë i mundur evidentimi i personave përgjegjës për trajtimin e kërkesës për informacion. Bazuar në nenin 15 të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” personi i ngarkuar me funksionin për të siguruar drejtimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e ministrisë si dhe bashkëpunimin me institucionet e pavarura është sekretari i përgjithshëm, në cilësinë e nëpunësit më të lartë civil. Bazuar në sa më sipër, duke mos zbatuar një nga funksionet e përcaktuara në ligj, lidhur me kërkesën për evidentimin e personave përgjegjës për trajtimin e praktikës në fjalë, sekretari i përgjithshëm i autoritetit publik ka marrë përsipër cilësitë e koordinatorit *ad hoc*, duke marrë në këtë mënyrë edhe



përgjegjësinë për refuzimin e dhënies së informacionit.

Në bazë të nenit 18, pika 2, gërma a) e Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” refuzimi për dhënien e informacionit, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë e cila varion nga 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) Lekë deri në 300.000 (treqind mijë) Lekë.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funkcionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Institutit të Studimeve Politike ndaj Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në shkronjën a) të pikës 2 të nenit 18, pikën 3 të nenit 18, pikën 2 dhe 3 të nenit 19, pikat 1 dhe 2 të nenit 21, nenin 22, shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

### **V E N D O S A:**

1. Pranimin e ankimit nr. 1495/5 Prot., datë 19.11.2019 të Institutit të Studimeve Politike, kundër Autoritetit Publik “Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të dokumentacionit nëpërmjet kërkesës së datës 10.09.2019, në lidhje me:
  - *Listën emërore të deputetëve dhe ish deputetëve që aktualisht zotërojnë pasaportë diplomatike nga MEPJ për shkak të funksionit parlamentar dhe ligjit mbi statusin e deputetit, brenda datës 17.11.2019.*
3. Dënimin e Sekretarit të Përgjithshëm në Autoritetin Publik, z. Armand Skrapi, në cilësinë e personit përgjegjës, me gjobë në vlerën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë në përputhje me nenin 19, pika 2 dhe 3 e ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Masa e dënimit me gjobë, shlyhet me këste mujore. Gjyba ekzekutohet nga zyra e financës së Autoritetit Publik brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Kundër vendimmarrjes në pikat 1, dhe 2, palët kanë të drejtën e ankimit brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
5. Kundër vendimmarrjes në pikën 3, personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni

administrativ, ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

6. Ky vendim u shpall sot në datë 10 . 12 .2019.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

